



Republika e Kosovës
Република Косово / Republic of Kosovo
Qeveria / Влада/ Government

*Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак /
Ministry of Communities and Return*

Fushë Kosovë, datë, 06.02.2023

Në mbështetje të kapitullit III të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në Ligjin nr.03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtareve të tyre në Republikën e Kosovës, Ligjin nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, shtojcën 14 të Rregullores (QRK)-nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në Udhëzuesin për subvencionimin e projekteve dhe aktiviteteve që promovojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre në Republikën e Kosovës, Ministria për Komunitete dhe Kthim, shpallë:

**THIRRJE PUBLIKE PËR SUBVENCIONIMIN E PROJEKTEVE DHE AKTIVITETEVE QË
PROMOVOJNË TË DREJTAT E KOMUNITETEVE JO SHUMICË DHE PJESËTARËVE TË
TYRE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

Me qëllim të stabilizimit, kthimit, ri-integrit, forcimit të qëndrueshmërisë ekonomike, promovimit të tolerances dhe bashkëjetesës në Republikën e Kosovës, Ministria për Komunitete dhe Kthim (me tej MKK), do të ofrojë mbështetje financiare individëve nga komuniteti jo shumicë të cilët aplikojnë me projekte dhe aktivitete që promovojnë të drejtat e komuniteteve jo shumicë.

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) do të subvencionojë projektet dhe aktivitetet për individët nga komuniteti jo shumicë, si në vijim:

1. Projektet/aktivitetet për forcim të qëndrueshmërisë ekonomike;
2. Projektet/aktivitetet për promovim të dialogut tolerances dhe bashkëjetesës në Republikën e Kosovës;
3. Projektet/aktivitetet e lemisë së arsimit dhe informimit;
4. Projektet/aktivitetet për hulumtime;
5. Projektet/aktivitetet për trajnime;
6. Projektet/aktivitetet nga lemia e mediave;
7. Projektet/aktivitetet nga lemia e sportit;
8. Projektet/aktivitetet nga lemia e kulturës;
9. Projektet/aktivitetet nga lemia e bujqësisë;
10. Projektet/aktivitetet nga lemia e blegtorisë.

MKK do të mbështes në subvencionim me mjete financiare deri në shumën prej pesëmijë (5,000.00)

Kriteret për subvencionimin e projekteve dhe aktiviteteve për personat fizik nga radhët e komuniteteve jo shumicë, janë si në vijim:

- 1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës dhe të jenë të moshës mbi tetëmbëdhjetë (18) vjet (të posedoj dokument identifikues të Republikës së Kosovës);*
- 2. Të mos ketë përfituar më parë mbështetje për të njejtin aktivitetet nga MKK apo burime tjera të financimit;*
- 3. Përputhshmëria me objektivat e subvencionimit (Projekt-propozimi duhet të ndikojë në promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtareve të tyre në Republikën e Kosovës, stabilizimin e komuniteteve, kthimin e qëndrueshëm, rritjen ekonomike, promovimin e dialogut, tolerancës dhe bashkëjetesës në Republikën e Kosovës, zhvillim të bujqësis dhe blektorisë, sportit, mediave dhe kulturës).*

Për të aplikuar për subvencionimin e aktiviteteve, aplikuesi duhet të dorëzoj dokumentacionin si në vijim:

- 1. Aplikacionin/Kërkesen (shkarko në web) të plotësuar më të gjitha të dhënat dhe të nënshkruar nga ana e aplikuesit;*
- 2. Projekt-propozimin (projekt propozimi duhet të përmbajë të gjitha informacionet që ndërlidhen më qëllimin, aktivitetet e projektit, planin kohor të realizimit të projektit, koston financiare, rezultatet e synuara dhe ndikimin e tyre);*
- 3. Kopjen e letërnjoftimit;*
- 4. Dëshminë e xhirollogarisë aktive të aplikuesit në njërën prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës;*
- 5. Deklaratën nën betim (shkarko në web) që nuk ka përfituar mbështetje për të njejtin aktivitet nga MKK apo nga burime tjera të financimit (e nënshkruar nga ana e aplikuesit);*
- 6. Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit?!*

Vëmendje:

- ✓ Në rast që personi fizik/aplikuesi do të jetë përfitues, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe (MKK dhe personi fizik), pjesë e secilës do të jenë edhe deklaratimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- ✓ Personat fizik/aplikuesi mund të përfitojnë vetëm një subvencionim.
- ✓ Përfitues do të jenë ata persona fizik/aplikues që janë renditur më pikë më të larta nga komisioni vlerësues, varësisht prej limiteve buxhetore të planifikuara.

Sqarim: Individet që kanë përfituar subvencionim me mjete financiare në të kaluaren për të njejtin projekt/aktivitet nga ana e MKK-së apo burime tjera të financimit, nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje.

Periudha e aplikimit:

Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në web faqen e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim <https://mkk.rks-gov.net/> . Të gjitha informatat e nevojshme dhe formularët për aplikim në këtë thirrje publike, mund t'i gjeni si në këtë web faqe gjithashtu mund t'i gjeni në ndërtesën e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Aplikuesit që dëshirojnë të aplikojnë sipas thirrjes publike duhet të shprehin interesimin e tyre duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin në kopje fizike në zyrën e arkivit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Rr. Nëna Terezë, pn. 12000 Fushë Kosovë/ Republika e Kosovës.

Paraqitja në këtë thirrje publike fillon me dt. 06.02.2023 kjo thirrje do të jete e hapur deri me dt. 17.02.2023, në orën 16:00 dhe aplikimet pas këtij afati nuk pranohen.

Informacione dhe sqarime shtesë mund të merren direkt nga zyrat e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.